REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

PROJEKT-VENDIM
NR. 28, DATË 18 / 03 /2026
"PËR MIRATIMIN E HARTËS SË SHËRBIMEVE PËR TË MITUR NË BASHKINË DEVOLL 2026-2027"

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 24 ''Sherbimet Sociale'', Ligjin nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror" I ndryshuar, Ligjin Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale" I ndryshuar, Ligjin nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"VKM nr. 578, datë 03.10.201''Per procedurat e referimit te menaxhimit te rastit, hartimit dhe permbajtjen e planit individual te mbrojtjes, financimin e shpenzimeve per zbatimin e ti, si dhe zbatimin e masave te mbrojtjes'', VKM nr. 111, datë 06.03.2019 '' "Për Procedurat dhe Rregullat për Kthimin dhe Riatdhesimin e Fëmijës".VKM Nr.353, date 12.06.2018'' Per rregullat e funksionimit te grupit Teknik Ndersektorial per mbrojtjen e femijeve prane bashkive dhe njesive administrative.'' VKM Nr.148, date 13.03.2018 '' Per percaktimin e rregullave te bashkepunimit midis mekanizmave institucionale, strukturave per mbrojtjen e femijeve ne nivel vendor dhe organizatave jofitimprurese per realizimin e politikave kombetare dhe vendore, si dhe per sherbimet e nevojshme per mbrojtjen e femijeve''.Me qëllim garantimin e mbrojtjes, mirëqenies dhe zhvillimit të plotë të të miturve në territorin e Bashkisë Devoll, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës,

PROPOZOJ:

1. Miratimin e "Hartës së Shërbimeve për të Mitur në Bashkinë Devoll", si dokument zyrtar që evidenton, strukturon dhe përditëson të gjitha shërbimet publike dhe jopublike që ofrohen për të mitur në territorin e Bashkisë Devoll.
2. Përcaktimin e Hartës së Shërbimeve si instrument pune detyrues për strukturat e Bashkisë Devoll dhe për mekanizmat ndërinstitucionalë të referimit dhe menaxhimit të rasteve të të miturve.
3. Ngarkimin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, në bashkëpunim me Specialistin për Mbrojtjen e Fëmijëve/Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës, për:
   - zbatimin e këtij vendimi;
   - përditësimin periodik të hartës së shërbimeve;
   - koordinimin ndërinstitucional me institucionet e ministrise, arsimit, shëndetësisë, drejtësisë, policisë dhe organizatat jofitimprurëse që operojnë në territor.

4.Përfshirjen në Hartë të këtyre kategorive të shërbimeve:

- Mbrojtja e fëmijëve dhe menaxhimi i rasteve në rrezik;
- Shërbimet për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në familje;
- Mbështetja për të mitur në konflikt me ligjin;
- Shërbimet e shëndetit mendor;
- Mbështetja për arsimin dhe parandalimin e braktisjes shkollore;
- Shërbimet për fëmijë me aftësi të kufizuara;
- Mbështetja ekonomike dhe sociale për familjet me fëmijë;
- Procedurat për trajtimin e të miturve të huaj të pashoqëruar.

5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Devoll

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve në nenin 55 të Ligjit Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL

Konceptoi: Sp.për mbroj.e fëm, KDHF
A. Hoxhallari
Pranoi: Përgj.i Sekt.të Kujd.Soc.dhe PAK.
M. Bejleri
Miratoi: Drejt. j Shërb. Soc.
Z. Sinani
Konfirmoi bazën ligjore:
Përgjegjëse e Sektorit Juridik
E. Avdo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr.1039 Prot. **Bilisht më,18.03.2026**

RELACION
MBI
PROJEKT-VENDIMIN
"PËR MIRATIMIN E HARTËS SË SHËRBIMEVE PËR TË MITUR NË BASHKINË DEVOLL 2026-2027"

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 24 ''Sherbimet Sociale'', Ligjin nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror" I ndryshuar, Ligjin Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale" I ndryshuar, Ligjin nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"VKM nr. 578, datë 03.10.201''Per procedurat e referimit te menaxhimit te rastit, hartimit dhe permbajtjen e planit individual te mbrojtjes, financimin e shpenzimeve per zbatimin e ti, si dhe zbatimin e masave te mbrojtjes'', VKM nr. 111, datë 06.03.2019 '' "Për Procedurat dhe Rregullat për Kthimin dhe Riatdhesimin e Fëmijës".VKM Nr.353, date 12.06.2018'' Per rregullat e funksionimit te grupit Teknik Ndersektorial per mbrojtjen e femijeve prane bashkive dhe njesive administrative.'' VKM Nr.148, date 13.03.2018 '' Per percaktimin e rregullave te bashkepunimit midis mekanizmave institucionale, strukturave per mbrojtjen e femijeve ne nivel vendor dhe organizatave jofitimprurese per realizimin e politikave kombetare dhe vendore, si dhe per sherbimet e nevojshme per mbrojtjen e femijeve''

Bashkia Devoll, me qendër qytetin e Bilishtit, bën pjesë në Prefekturën e Qarkut Korçë dhe ka një sipërfaqe prej 500 km² me një popullsi prej 40,428 banorë dhe 13,266 familje. Bashkia përbëhet nga qyteti Bilisht dhe katër Njësi Administrative. Kryeqendra administrative e rrethit është qyteti Bilisht.

Lëvizjet demografike, si brenda njësive administrative drejt qytetit Bilisht, ashtu edhe nga rrethi Devoll drejt qyteteve të tjera të Shqipërisë, kanë sjellë sfida të ndryshme sociale dhe ekonomike. Këto sfida ngrenë nevojën për një strukturë të mirëorganizuar të shërbimeve për fëmijët dhe familjet në vështirësi, duke garantuar mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre të plotë.

Qëllimi i hartës së shërbimeve

Qëllimi i këtij relacioni është identifikimi, kategorizimi dhe publikimi i të gjitha shërbimeve për të mitur, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja, mirëqenia dhe zhvillimi i plotë i fëmijëve sipas interesit më të lartë të fëmijës. Bashkia Devoll, përmes Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe sektorëve përkatës, krijon dhe administron shërbime sociale për:

- Fëmijë dhe familje në nevojë
- Të mitur në situatë rreziku
- Të mitur të huaj të pa shoqëruar
- Të mitur në konflikt me ligjin

STRUKTURA PËRGJEGJËSE

- **Drejtoria Përgjegjëse:** Drejtoria e Sherbimit Social
  Sektori/NJMF: Sektori i Kujdesit Social
  Numri i Specialistëve për Mbrojtjen e Fëmijëve: 1 punonjes PMF
  Kontakt institucional: Ariana Hoxhallari
  Email zyrtar:Ariana.Hoxhallari@bashkiadevoll.gov.al
  Numër telefoni:0697894813

Shërbimet kryesore për të mitur

1. Mbrojtja e fëmijëve

- Identifikimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në rrezik
- Trajtimi i rasteve të dhunës, abuzimit, keqtrajtimeve dhe neglizhencës
- Referimi i rasteve tek institucionet përkatëse: polici, gjykatë, shërbime shëndetësore dhe psikologjike
- Monitorimi i fëmijëve në situatë socio-ekonomike të vështirë
- Mbështetje për familjet vulnerabël në mbledhjen e dokumentacionit për asistencë
- Ndihmë dhe këshillim psikologjik për fëmijët dhe familjet në vështirësi

Bashkëpunim ndërinstitucional dhe me OJF:

- Kisha Ungjillore Bilisht dhe Motrat Françeskane ofrojnë ndihma ushqimore, veshje dhe medikamente për fëmijët në nevojë.
- Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor Korçë, qendrat shëndetësore Devoll dhe Spitali Rajonal Korçë ofrojnë:
  - Shoqërim për vizita psikiatrike dhe vlerësime psikologjike
  - Terapia individuale
  - Shërbime të specializuara sipas rastit
  - OJF te ndryshme bashkepunojne nder vite me Bashkine per te sjelle sherbime ne dnihme te femijeve dhe familjeve te tyre.

2. Mbështetje për të mitur në konflikt me ligjin

- Koordinim me gjykatën, prokurorinë, shkollat dhe policinë
- Shoqërim për intervistime, seanca gjyqësore dhe vizita në familje
- Mbështetje emocionale dhe edukative për rikthimin në shkollë
- Masat emergjente për mbrojtjen nga dhuna dhe abuzimi
- Asistim ligjor në zyrat juridike falas
-

3. Mbështetje për arsim

- Identifikim i fëmijëve që braktisin shkollën
- Referim dhe ndjekje e fëmijëve për rikthim në shkollë
- Mbështetje për familjet në vështirësi për vijimin e shkollës
- Shërbime mbështetëse për fëmijët me AK (mësues ndihmës, terapista, këshillim psikologjik)

4. Shërbime të Qendrës Shumëfunksionale Komunitare Devoll

- Terapia zhvillimore dhe fizioterapia
- Këshillim psikologjik dhe mbështetje për prindër të divorcuar
- Shpërndarja e paketave ushqimore, mjeteve shkollore dhe lodrave
- Aktivitetet parandaluese dhe ndërgjegjësuese në komunitet dhe shkolla

5. Të mitur të huaj të pa shoqëruar

- Identifikimi dhe konfirmimi i statusit
- Vlerësimi i nevojave psikologjike, sociale dhe shëndetësore
- Vendosja nën mbrojtje dhe koordinimi me kujdestarë ligjorë
- Shoqërim në qendra rezidenciale ose struktura të liçensuara
- Mbështetje psiko-emocionale dhe shëndetësore

Konceptoi: Sp.për.mbroj.e fëm, KDHF
A. Hoxhallari
Pranoi: Përgj.i Sekt.te Kujd.Soc.dhe PAK.
M. Bejleri

Miratoi
Drejtor i Sherbimeve Sociale
Zerina Sinani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. **Prot.** **Bilisht më, / / 2026**

HARTA E SHËRBIMEVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Njësia e Vetëqeverisjes Vendore: Bashkia Devoll
Qarku: Korçë

Sipërfaqja: 500 km²
Popullsia totale: 40,428 banorë
Numri i familjeve: 13,266
Numri i Njësive Administrative: 4

Popullsia sipas njësive administrative është si më poshtë vijon:

1. Qyteti Bilisht 10 407 banorë, 3 685 familje, 1 676 fëmijë
2. Njësia Administrative Miras 9 406 banorë, 3 179 familje, 1 528 fëmijë
3. Njësia Administrative Qëndër Bilisht 8 350 banorë, 2 849 familje, 1 359 fëmijë
4. Njësia Administrative Progër 5 696 banorë, 1 892 familje, 924 fëmijë
5. Njësia Administrative Hoçisht 6 569 banorë, 2 273 familje , 1 062 fëmijë

II. BAZA LIGJORE

Hartimi i kësaj harte shërbimesh mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 24 ''Sherbimet Sociale''
- Ligjin nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror"
- Ligjin nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale"
- Ligjin nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"
- VKM nr. 578, datë 03.10.201''Per procedurat e referimit te menaxhimit te rastit, hartimit dhe permbajtjen e planit individual te mbrojtjes, financimin e shpenzimeve per zbatimin e ti, si dhe zbatimin e masave te mbrojtjes''.

- VKM nr. 111, datë 06.03.2019 '' "Për Procedurat dhe Rregullat për Kthimin dhe Riatdhesimin e Fëmijës".
- VKM Nr.353, date 12.06.2018'' Per rregullat e funksionimit te grupit Teknik Ndersektorial per mbrojtjen e femijeve prane bashkive dhe njesive administrative.''
- VKM Nr.148, date 13.03.2018 '' Per percaktimin e rregullave te bashkepunimit midis mekanizmave institucionale, strukturave per mbrojtjen e femijeve ne nivel vendor dhe organizatave jofitimprurese per realizimin e politikave kombetare dhe vendore, si dhe per sherbimet e nevojshme per mbrojtjen e femijeve''.

III. STRUKTURA PËRGJEGJËSE

Drejtoria Përgjegjëse: Drejtoria e Sherbimit Social
Sektori/NJMF: Sektori I Kujdesit Social
Numri i Specialistëve për Mbrojtjen e Fëmijëve: 1 punonjes PMF
Kontakt institucional: Ariana Hoxhallari
Email zyrtar:Ariana.Hoxhallari@bashkiadevoll.gov.al
Numër telefoni:0697894813

Qëllimi i shërbimeve

Qëllimi i hartimit dhe përpilimit të kësaj database shërbimesh konsiston në mbrojtje, mirëqënie dhe zhvillim të plotë të fëmijëve në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Bashkia Devoll përmes **Drejtorisë së Shërbimeve Sociale** krijon dhe administron shërbime sociale për grupe në nevojë, përfshirë **fëmijë, familje në nevojë dhe të mitur**. Këto shërbime per te miturit do ti ndajme sipas nje harte sherbimesh qe ofrohen ne Bashkine Devoll, si më poshte:

IV. HARTA E SHËRBIMEVE SIPAS FUSHAVE

A. SHËRBIME PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

Nr	Lloji i Shërbimit	Ofruesi	Vendndodhja	Kategoria Përfituese	Mënyra e Referimit	Kapaciteti	Kontakt
1	Identifikim dhe menaxhim rasti	PMF	Bashkia Devoll	Fëmijë në rrezik	Referim institucional / vetëreferim	1 punonjes per 3000 femije ne zbatim te ligjit	PMF/GTN

Nr	Lloji i Shërbimit	Ofruesi	Vendndodhja	Kategoria Përfituese	Mënyra e Referimit	Kapaciteti	Kontakt
2	Ndërhyrje në rast dhune	PMF / Policia/Psikolog/GTN	Bashkia Devoll, Komisariati/PMF/ Psikolog I Licensuar nga prokuroria	Fëmijë viktima Femijet ne rrezik dhe te dhunuar fizikisht dhe psikologjikisht	Referim emergjent Referim emergjent nga Policia/Institucionet tjera, apo vetereferim	1 punonjes per 3000 femije ne zbatim te ligjit	PMF/GTN
3	Hartim Plan Individual Mbrojtjeje	PMF	Bashkia Devoll	Fëmijë në rrezik	Sipas VKM 578	1 punonjes per 3000 femije ne zbatim te ligjit	PMF
4	Monitorim raste socio-ekonomike	PMF/Psikolog/ GTN	Bashkia Devoll	Fëmijë në nevojë	Referim nga shkolla / komuniteti/Policia/Familjaret	1 punonjes per 3000 femije ne zbatim te ligjit	PMF/GTN

MBROJTJA E FËMIJËVE

Ku përfshihen:

- Identifikimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në rrezik.
- Trajtimi i rasteve të dhunës në familje, abuzimit, keqtrajtimeve, neglizhencës etj.
- Referim i rasteve për të mitur në polici, gjykatë, shërbime shëndetësore dhe psikolgjike.
- Monitorim i të miturve në situatë të vështirë socio-ekonomike.
- Mbështetje për familje vulnerabël dhe fëmijë, duke ndihmuar në qasje drejt asistencës në mbledhjen e dokumentacioneve përkatëse në vartësi të rastit.

- ❖ Ndihmë për fëmijë që përballen me rrezik, dhune psikologjike. Fizike, ngacmim seksual, apo probleme sociale;
- ❖ Mbështetje psikologjike/këshillim për familjet dhe fëmijët në vështirësi sociale

B. SHËRBIME SHËNDETËSORE DHE PSIKO-SOCIALE

Nr	Lloji i Shërbimit	Institucioni Ofrues	Vendndodhja	Kategoria	Mënyra e Referimit	Kontakt
1	Vlerësim psikiatrik	QKSHM	Korçë	Fëmijë me probleme sjelljeje	PMF	Mjeku Psikiatër/ Qëndrave shëndetësore/Psikologu, PMF
2	Vlerësim psikologjik	QKSHM	Korçë	Fëmijë në nevojë	PMF	Mjeku Psikiatër/ Qëndrave shëndetësore/Psikologu, PMF
3	Terapi individuale	QKSHM/Psikologia e Qendres Shumefunskionale Komunitare Devoll	Korçë/ Bashkia Devoll	Fëmijë me problematika emocionale	Qëndrat shëndetësore/Psikologu, PMF	Mjeku Psikiatër/ Qëndrave shëndetësore/Psikologu, PMF
4	Shërbime të specializuara	Spitali Rajonal	Korçë	Sipas rastit	Qëndrat shëndetësore/Psikologu, PMF	Mjeku Psikiatër/ Qëndrave shëndetësore/Psikologu, PMF

- ✓ ***Bashkëpunim ndërinstitucional me Qëndrën Komunitare të Shëndetit Mendor Korçë, qëndrat shëndetësore të rrethit Devoll dhe Spitalin Rajonal Korçë për referim, koordinim dhe menaxhimin e rasteve për shërbime të specializuara.***

Nëpërmjet koordinimit dhe bashkëpunimit me Qëndrën Komunitare të Shëndetit Mendor Korçë nga mjekët specialist dhe psikologëve pranë kësaj qëndre kryhen këto shërbime për të mitur ose familje në nevojë që kanë të mitur.

- ➢ Asistim dhe shoqërim i të miturve për kryerjen e vizitave mjekësore psikiatrike për rastet që kanë probleme me sjelljen.
- ➢ Shoqërim i të miturve për kryerjen e Vlerësimit psikologjik dhe social – psikologjik nga psikologët e QKSHM Korçë
- ➢ Shoqërimi i të miturve për kryerjen e Terapisë individuale nga psikologët e QKSHM Korçë
- ➢ Shoqërimi i të miturve pranë Spitalit Rajonal Korçë për marrjen e shërbimeve të specializuara sipas rastit.

C. MBËSHTETJE PËR FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Nr	Shërbimi	Institucioni	Përshkrim i shkurtër	Referimi	Kontakt
1	Asistim në Prokurori	Prokuroria e Rethit Gjyqesor Korçe	Shoqërim/intervistim	PMF/OPGJ/Prokuror	PMF,OPGJ
2	Përfaqësim procedural	Gjykate	Seanca gjyqësore	PMF/Gjykate	PMF/Sekretar gjykate/Njoftim zyrtar per seancen gjyqesore
3	Mbështetje psiko-sociale	PMF / Shkolla/QSHK	Ndjekje shkollore me seanca nga psikologu I shkolles, dhe terapi me psikologun e qendres.	PMF/Psikologu i shkolles	PMF/Psikolog i shkollës
4	Ndihmë juridike falas	Zyra Ligjore Juridike Falas, Korce	Konsulencë ligjore dhe ndjekje te procesit gjyqesor	PMF/Psikologu I shkolles	Specialiste e zyres ligjore juridike falas, Korçë.

✓ **Bashkëpunim dhe koordinim ndërinstitucional me gjykatë, prokurori, shkollat, policinë, zyrën përmbarimore, Ndihme juridike falas etj**

- Asistim dhe shoqërim i të miturve për intervistim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, psikologut klinik ose të liçensuar sipas problematikës që ka rasti.
- Shoqërim dhe përfaqësim i të miturve si përfaqësuese proceduriale tek seancat e ndryshme gjyqësore.
- Asistim dhe shoqërim i të miturve gjatë intervistimit në Komisariatin e Policisë Devoll dhe Korçë për të mitur në konflikt me ligjin.
- Vizitë në familje pë vlerësimin e kushteve socio-ekonomike për të mitur.
- Mbështetje emocionale për ndjekjen e shkollës nga specialistja për mbrojtjen e fëmijëve/ psikologia e QSHK Devoll, psikologët dhe punonjësit social të shkollave.
- Mbrojtja e të miturve nga abuzimi dhe dhuna nëpërmjet ndërhyrjes në rastet e dhunës psikologjike, fizike, emocionale etj me qëllim parandalimin e saj
- Marrja e masave emergjente për mbrojtjen e të miturve kur ka rrezik të menjëhershëm
- Këshillim për familjet dhe fëmijët në vështirësi socio-ekonomike
- Asistim dhe shoqërim i fëmijëve të mitur ose familjeve në nevojë që kanë fëmijë të mitur për të përfituar asistencë ligjore tek zyra juridike falas në qytetin e Korçës si shërbim i specializuar.

- Referim dhe shoqërim i të miturve në shërbime rezidenciale apo komunitare kur është e nevojshme
- Asistim dhe shoqërim i të miturve gjatë takimeve prindërore në prezencë të përfaqësuesve të zyrës përmbarimore në zbatim të vendimit të gjykatës.

D. MBËSHTETJE PËR ARSIMIN

Nr	Shërbimi	Ofruesi	Kategoria	Mënyra e Identifikimit	Kontakt
1	Identifikim braktisje	Shkolla / Shërbimi Psikosocial/PMF	Nxënës në rrezik braktisje te shkolles	Raportim shkollor	PMF, Psikologe e Shkolles/Dr.arsimore prane Bashkise
2	Rikthim në shkollë	PMF + Shkolla/Punonies QSHK	Nxënës braktisës	Plan ndërhyrjeje	PMF, Psikologe e Shkolles/QSHK
3	Mësues ndihmës	Shkolla/QSHK	Fëmijë me AK	Vendim KMD	Drejtoria e Shkolles/mesues ndihmes prane QSHK

❖ ***Bashkëpunim dhe koordinim i punës me shërbimin psikosocial të shkollës ku përfshihen psikolog dhe punonjës social për*** :

- identifikimin, e fëmijëve që braktisin shkollën
- referim i rasteve
- ndjekje
- mbështetje për familjet në vështirësi për vijimin e shkollës
- bashkëpunim me shkollat e rrethit Devoll për rikthimin etj miturve në shkollë deri në përfundim të vitit akademik.
- monitorim i rasteve të të miturve me probleme socio-ekonomike apo probleme të tjera si rezik braktisje të shkollës, mosfrekuentim jo i regullt i procesit mësimor etj.
- Referim i rasteve të fëmijëve me AK për përfitimin e shërbimeve mbështetëse me mësues ndihmës në shkollë.

E. SHËRBIME TË QENDRËS SHUMËFUNKSIONALE KOMUNITARE

Emërtimi i Qendrës: Qendra Shumefunksionale Komunitare Devoll
Adresa: Bilisht, Devoll
Stafi (numri dhe profili): 11 Punonjës

Nr.	Funksion
1	Përgjegjëse
1	Fizoterapist
2	Punonjës.Sociale
1	Psikologe
1	Kuzhiniere
3	Punonjes Ndihmes
2	Mesuese Ndihmese

Nr	Shërbimi	Përshkrimi	Kapaciteti	Frekuenca	Kontakt
1	Terapi zhvillimi	Mbështetje për fëmijët me vonesa zhvillimore (motorike, gjuhësore, sociale).	10 femije ne jave	Cdo dite me individe te ndryshem	inaxheko6@gmail.com marinanikollofska@gmail.com
2	Këshillim psikologjik	Seanca individuale ose familjare për mbështetje emocionale dhe psikologjike.	5 raste ne jave (sipas rastit)	2 here ne jave	marinanikollofska@gmail.com
3	Fizioterapi	Trajtim për përmirësimin e lëvizshmërisë, forcës dhe koordinimit.	15 paciente ne jave	2 here ne jave	physiotherapyservice96@gmail.com
4	After-school	Program edukativ dhe aktivitete zhvillimore pas mësimit për fëmijë.	15-20 femije	Cdo dite	erindaskoti86@gmail.com erjonashaholli22gmail.com

QSHK Devoll afron shërbime për kategori të ndryshme si AK (autizëm, paralizë cerebrale spastike, sindroma west, prapambetje mendore etj), dhunë në familje, ngacmim seksual, ngarkesë emocionale, prindër të divorcuar, probleme socio-ekonomike etj, trajtim I rasteve emergjente 72 ore.

- **Shërbimet e ofruara:**

1. Terapi zhvillimi – shërbimi ofrohet nga punonjësi social i QSHK Devoll
2. Këshillim psikologjik – shërbimi ofrohet nga psikologu i QSHK Devoll
3. Fizioterapi - shërbimi ofrohet nga fizioterapisti i QSHK Devoll
4. Mësues ndihmës për kryerjen e detyrave after-school
5. Shpërndarja e paketave ushqimore, mjeteve shkollore, medikamenteve, veshmbathjeve, lodrave dhe çantave – stafi i QSHK Devoll
6. Zhvillimi i aktiviteteve sociale dhe kulturore
7. Zhvillimi i kampeve verore per femije.

- **Parandalimi dhe ndërgjegjësimi**

- Zhvillimi i aktiviteteve parandaluese në komunitet dhe institucione arsimore.
- Informim mbi të drejtat e fëmijëve dhe mekanizmat mbojtës të tyre.
- Dhënia e informacionit mbi fenomenin negativ të braktisjes shkollore apo fenomene tjera negative.

F. NDIHMË EKONOMIKE DHE MBËSHTETJE SOCIALE

Nr	Skema	Përfitues	Numri Aktual i Përfituesve	Buxheti Vjetor	Kontakt
1	Ndihmë ekonomike	Familje me fëmijë	388		Administrator i NE , PMF
2	Pagesë AK	Fëmijë me aftësi ndryshe	48	3.439,872 leke	Specialist i PAK, PMF
3	Ndihma emergjente(familjet me femijë)	Raste në krizë	200 paketa ushqimore, 70 veshmathje, 60 mjete didaktike etj)	1 500 000 leke	PMF në bashkepunim me aktore të tjerë si OJF/Fondi Social dhe vet buxheti i bashkisë etj.

NDIHMË EKONOMIKE / MBËSHTETJE SOCIALE

- Ndihmë ekonomike për familjet në nevojë me fëmijë
- Pagesa e aftësisë ndryshe për fëmijë me AK
- Mbështetje me paketa ushqimore ose ndihma emergjente për familjet në nevojë me fëmijë.

G. SHËRBIME PËR TË MITUR TË HUAJ TË PASHOQËRUAR

Nr .Shërbimi	Institucioni	Përshkrimi	Referimi	Kontakt
1 Identifikim dhe vlerësim	PMF /Policia kufitare	Ndjekje e rastit nga PMF dhe aktoret e tjerë në pikën kufitare Kapshticë	Policia	PMF
2 Strehim emergjent	Policia Kufitare Kapshtice	Strehim I te mitureve ne qendrat e krijuara per ta ne piken kufitare Kapshtice.	Referim	Referim / komuniteti/ media/Policia Kufitare
3 Caktim kujdestari	Gjykata	Dergimi i rastit ne Gjykatë për të vendosur kujdestarine	Gjykata	PMF/Sekretar gjykate

Specialistja për mbojtjen e fëmijëve/KDHF për të miturit e huaj të pa shoqëruar ofron këto shërbime:

Në zbatim të Ligjit 18/2017 "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", neni 56, 57, "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës" në VKM Nr.111 datë 06.03.2019 "Për Procedurat dhe Rregullat për Kthimin dhe Riatdhesimin e Fëmijës"

- Identifikim i të miturit të huaj të pa shoqëruar dhe konfirmim i statusit të tij.
- Vlerësim i nevojave (psikologjike, sociale, shëndetësore etj) dhe adresimin e tyre në rast se ka për shërbime më të specializuara.
- Vlerësim i rezikut si abuzim, dhunim, keqtrajtim etj në rast se ka ose jo sipas rastit specifik
- Vendosja nën mbrojtje e të miturit të huaj të pa shoqëruar sipas legjislacionit shqitar në fuqi.
- Koordinon caktimin e kujdestarit/mbrojtësit ligjor në rast se ka ose jo.
- Bashkëpunim me Policinë, strukturat e migracionit dhe gjykatën kur është e nevojshme.
- Referim për strehim emergjent ose afatmesëm(qëndra rezidenciale, struktura të liçensuara).
- Sigurimi i vakteve ushqimore, veshmbathjeve dhe shërbimeve shëndetësore gjatë qëndrimit të tyre në SPK Kapshticë ne bashkepunim me OJF.
- Mbështetje psikoemocianale për rastet e të miturve të huaj të pa shoqëruar kur ata kanë nevojë sipas rastit dhe problematikës në rast se konstatohet gjatë intervistimit në prezencë të njohësit të gjuhës arabe të liçensuar për rastet.

- Shoqërim i të miturve të huaj të pa shoqëruar në qëndër rezidenciale ose struktura të liçensuara për shtetasit e mitur të huaj.

V.ANALIZA E NEVOJAVE DHE BOSHLLËQEVE

1. Shërbime që mungojnë në territor

1. ❖ **Qendër emergjente rezidenciale 24/7 vetem për fëmijët në rrezik të menjëhershëm**, brenda territorit të bashkisë (aktualisht referohen jashtë territorit).
2. ❖ **Shërbim i specializuar për trajtimin e traumës dhe abuzimit seksual** (terapi e specializuar për viktimat e dhunës).
3. ❖ **Program rehabilitimi dhe riintegrimi për të miturit në konflikt me ligjin** në nivel vendor.
4. ❖ **Qendër ditore specifike për adoleshentët (14–18 vjeç)** me fokus parandalimin e devijancës, varësive dhe braktisjes shkollore.
5. ❖ **Shërbim i ndërmjetësimit familjar (family mediation)** për raste divorci dhe konflikte prindërore.
6. ❖ **Psikolog klinik me kohë të plotë në territor**, pasi aktualisht shërbimi realizohet kryesisht përmes referimit në Korçë.
7. ❖ Program i strukturuar për **prindërimin pozitiv** dhe edukimin prindëror në komunitet.

2.Nevoja për burime njerëzore shtesë:

Duke marrë në konsideratë raportin ligjor 1 PMF / 3000 fëmijë dhe numrin real të fëmijëve në territor:

- ➤ Shtim në Strukturë i të paktën **1–2 Specialistëve për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF)**.
- ➤ Punësim i një **Psikologu klinik me kohë të plotë** pranë Bashkisë.
- ➤ Shtim i një **Punonjësi Social për Njësitë Administrative rurale**.
- ➤ Jurist i dedikuar për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve (me kohë të pjesshme ose të plotë).
- ➤ Rritje e kapaciteteve të stafit të QSHK me terapist zhvillimi dhe logoped shtesë.

3. Nevoja për financim shtesë

- ❖ Buxhet për **trajnime të specializuara** të stafit (menaxhim traume, intervistim miqësor për fëmijët, drejtësi miqësore për të mitur).
- ❖ Financim për programe parandaluese në shkolla dhe komunitet.
- ❖ Rritje fondi për **ndihmë emergjente (72 orë)**.
- ❖ Sigurim fondesh për mbështetje psikosociale afatgjatë për fëmijët viktima.

4. Rekomandime për përmirësim